



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

**VENDIM**

**Nr. 6, datë 05.04.2019**

**PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURAVE  
DHE NJOFTIMIN E SUBJEKTIT QË E KA VËNË NË LËVIZJE, GJYKATËN E  
LARTË, PËR TË VLERËSUAR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E  
KANDIDATURAVE**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2 të nenit 218 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 49 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:**

1. Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për :

- a) pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese, me mandat të plotë deri në vitin 2025, të shpallur në datën 16.01.2017;
- b) pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese, me mandat plotësues deri në vitin 2022, të shpallur në datën 21.02.2019.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**Ardian Dvorani**